



Organizata Jo-qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe  
EC MA NDryshe

3 tetor 2013, Prizren

**KOMUNIKATË PËR MEDIA**  
**Komuna e Prizrenit shkel Ligjin për Qasje në Dokumente Publike**

Në kuadër të projektit të monitorimit të transparencës së ekzekutivit komunal të Prizrenit, EC Ma Ndryshe gjatë muajit shtator ka shqyrtuar çështjen e zbatimit të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, meqë ka pranuar ankesa se ka shkelje në këtë drejtim.

Ankesa e parë është paraqitur nga një mësimdhënës, i cili qysh në gusht të vitit të kaluar i është drejtuar autoriteteve të komunës, duke ngritur shqetësimin për uzurpimin e pronës së një shkolle nga një operator ekonomik. Ndërsa rasti i dytë është identifikuar nga Instituti GAP që me 24 korrik 2013 nga Komuna e Prizrenit ka kërkuar qasje në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2014-2016.

Në lidhje me rastin e parë, edhe pse kërkesa e mësimdhënësit nuk shquhet për qartësi, ajo të paktën e ka merituar një përgjigje adekuate nga autoritetet komunale, pasi që kërkesa i është drejtuar Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe kryetarit të Komunës së Prizrenit. Neni 6, i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike (që mund të gjendet në linkun: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-215-alb.pdf>) thotë: “Nëse kërkesa nuk është sa duhet e saktë, institucioni publik kërkon nga kërkuuesi që ta qartësojë kërkesën dhe i ndihmon kërkuuesit që ta bëjë këtë”.

EC Ma Ndryshe ka kërkuar sqarime nga Komuna e Prizrenit në lidhje me këtë çështje. DKA ka njoftuar “EC Ma Ndryshen” me vendimin e Kuvendit të Komunës nr. 01/011-8415 të datës 4 korrik 2013, dhe me konfirmimin e Ministrisë së Administratës së Pushtetit Lokal nr. 0204-14/15 të datës 05.08.2013, në lidhje me këtë çështje, por nuk ka ofruar një sqarim nëse i është dhënë ndonjë përgjigje mësimdhënësit.

Neni 7, paragrafi 8, përcakton se “Institucioni publik obligohet që brenda shtatë (7) ditëve, prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerr vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të japë përgjigje me shkrim për të arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesshëm dhe informon kërkuuesin për të drejtën që ai ka për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim. Refuzimi i kërkesës bëhet me aktvendim me shkrim për refuzim të saj”. Ndërsa neni 10 përshtet se mos përgjigja e institucionit publik brenda afatit të caktuar konsiderohet si përgjigje negative dhe i jep të drejtë kërkuuesit që të fillojë procedurën para autoriteteve tjera shtetërore.

Kërkesa e mësimdhënësit është bërë më 7 gusht 2012. Ai thotë se nuk ka marrë përgjigje nga autoritetet komunale. Në të njëjtën kohë komuna, kërkesën e sipërpërmendur të mësimdhënësit, as që e ka regjistruar në listën e kërkesave të pranuar për vitin 2012, në të cilin dokument figuron se numri i përgjithshëm i kërkesave të pranuar është 19 dhe se qasja është lejuar në të 19 rastet.

Parimet e përcaktuara në nenin 7 nuk janë respektuar as në rastin e Institutit GAP, që me 24 korrik 2013 nga Komuna e Prizrenit ka kërkuar qasje në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2014-2016, por nuk ka marrë asnjë përgjigje nga ky institucion publik ([http://www.institutigap.org/documents/1479\\_PRIZRENI.pdf](http://www.institutigap.org/documents/1479_PRIZRENI.pdf), faqe 6) .

Bazuar në këto të gjetura, EC Ma Ndryshe konstaton se Komuna e Prizrenit ka dështuar në zbatimin e dispozitave të caktuara të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, në këto dy raste. Ky dështim nuk përputhet me zotimet për qeverisje transparente dhe të mirë.

Për këto arsye EC Ma Ndryshe rekomandon Komunën e Prizrenit që:

- Të merr masa adekuate për zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumentet Publike në secilin rast, pa përjashtime;
- Të informojë publikun për të drejtat e tij për qasje në dokumente zyrtare dhe mënyrën në të cilën kjo e drejtë mund të ushtrohet;
- Të ofroj ndihmë dhe këshilla për qytetarët në lidhje me hartimin e kërkesave për qasje në dokumentet publike; dhe
- Të siguroj pjesëmarrjen e angazhimin e qytetarëve me hapjen e të dhënave.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së ekzekutivit do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Tanimë të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prizrenit dhe të Mamushës publikohen në baza të rregullta në ueb-faqen e projektit, [www.online-transparency.org](http://www.online-transparency.org).

Ju faleminderit për bashkëpunimin tuaj,

Elmedina Baxhaku, Monitoruese  
OJQ EC Ma Ndryshe  
Rr. Saraçët, Nr. 5 - Prizren  
Rr. Zeki Shulemaja, Nr. 2 - Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
+381 38 224 967 & +381 29 222 771



British Embassy  
Pristina

*Projekti "Transparenca online e komunave të Prizrenit dhe Mamushës" prej muajit maj 2013 përkrahët financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.*